

**GO GREEN SH.P.K**  
**RRUGA LUIJGJ GURAKUQI, PALLATI 89, SHKALLA 1, AP. 33, TIRANE**  
**NUIS L81911036L**

---

**VENDIM**  
**I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË**

Sot, më datë 31/10/2022, në orën 10.30, selinë e Shoqërisë GO GREEN sh.p.k, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L81911036L (më tej referuar si "Shoqëria"), me seli të regjistruar në adresën: Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shkalla 1, Ap. 33, Tirane, u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me praninë e ortakut të vetëm:

Shoqëria **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 12, ABA Business Center, Tirane, Shqipëri, me administratore, Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, e lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.038523830, dhe me numër personal I35203147R, në cilësinë e Administratorit (këtu e në vijim "Ortaku i Vetëm").

Meqenëse në mbledhje merr pjesë Ortaku që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë konsiderohet e mbledhur rregullisht dhe vendimet e marra plotësisht të vlefshme.

Znj. Edlira Muka, e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj. Migena Kolonja të kryejë funksionin e sekretarit të mbledhjes.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**REND DITE**

- I. Rritja e kapitalit themeltar të Shoqërisë me një vlerë 3,200,000 Lekë;**
- II. Të ndryshme**

\*\*\*\*\*

Në përputhje me parashikimet e Statutit, Shoqëria ka një kapital në shumën 1,150,000 Lekë, i cili përbëhet nga një kuotë e vetme me të njëjtën vlerë nominale. Për arsyen operacionale të Shoqërisë, Ortaku i Vetëm dëshiron të kontribuojë në rritjen kapitalit të Shoqërisë me një vlerë 3,200,000 Lekë. Asambleja pasi e shqyrtoi dhe vlerësoi me kujdes pikat e rendit të ditës si më lart,

**VENDOSI**


1. Të miratojë rritjen e kapitalit të Shoqërisë me kontribut në para në vlerën 3,200,000 Lekë (tre milion e dyqind mijë lekë). Rritja e kapitalit do të realizohet duke rritur vlerën nominale të kuotës ekzistuese të Shoqërisë. Pas rritjes, kapitali i regjistruar i Shoqërisë do të bëhet 4,350,000 Lekë (katër milion e treqind e pesëdhjetë mijë lekë), i përbërë nga një kuotë e vetme me po këtë vlerë nominale.
2. Autorizohet Administratori Z. Genci Beribashi që, duke vepruar personalisht ose duke autorizuar persona te tjerë të bëjë të mundur regjistrimin e këtij vendimi ne regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe në çdo institucion tjetër ku regjistrimi apo njoftimi është i kërkuar me ligj.

\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

\*\*\*\*\*

KRYETARI

  
Edlira Muka



SEKRETARI

  
Migrena Kolonja